

SPECIFIKIME TEKNIKE

“PROJEKTE MODEL” PËR RINDËRTIMIN E SHTËPIVE INDIVIDUALE, ME KOSTO TË ULËT DHE EFIÇENCË ENERGJIE

Godina 50 cm e ngritur nga niveli i tokës dhe është e mbështetur mbi një pllakë themeli b/a monolite C16/20. Pllaka e betonit është e hidroizoluar me emulsion dhe bitum. Konstruksioni I përdorur është beton-arme dhe tullë. Muret e jashtme janë me tulla me 8 vrima, $t=20\text{cm}$, II perz M 15 ndërsa muret e brendshme me tulla me 8 vrima, $t=10\text{cm}$, II perz M 15. Struktura është e mbështetur në një sistem kolonash b/a $25\times 25\text{ cm}$ dhe lartësi 280 cm. Fasada është e veshur me sistem kapot, me polisterol $t=5\text{cm}$, rrjete dhe suva. Muret dhe tavanet e brendshme janë me suva, me pompë, II perzier M 25.




Figura 1 Detaj i pllakes së betonit

Figura 2 Detaj I murit dhe Çatisë

Çatia është sistem kapriatë çeliku me pjerrësi 25 gradë. Eshtë e termoizoluar me Lesh Guri $t=5\text{cm}$ ($\lambda=0.037\text{w/m.k}$, $R=1.35\text{ m}^2.\text{K/W}$). Mbi kapriatën e çelikut kapet me anë të profileve mbajtës metalik një shtresë OSB 11 mm, membrana avull-izoluese dhe mbi to mbulesa me tjegulla marsejeze. Tavanet janë të mbyllura me kartonxhes.

Shtrimi I hapësirave të brendshme është me pllakë qeramike. Tualeti dhe kuzhina janë të veshura me pllakë majolike dhe me hidroizolim 1 guajn.